



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.109/2016

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nenad Lazić kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Internews Kosova, paraqitur kundër Arlind Istogut kryesues i vendvotimit 0318e/02d, për shkak të asistimit tek votuesit gjatë ditës së zgjedhjeve për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Drenasit të datës 04.12.2016, në seancën e panelit të mbajtur me 07.12.2016, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa Anr.109/2016 e datës 05.12.2016 e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Internews Kosova.

Arsyetim

Me datën 05.12.2016 Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Internews Kosova ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën pretendohet se kryesuesi i vendvotimit 0318e/02D Arlind Istogu gjatë ditës së votimit për zgjedhjet e mbajtura në Gllogoc në kundërshtim me nenin 89 par 5 të LZP-së ka asistuar njërin nga votuesit. Parashtruesi i ankesës si dëshmi ka bashkangjitur një CD në të cilin pretendon se mund të shihet ngjarja.

PZAP-i, lidhur me ankesën në fjalë e informoi Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) duke kërkuar që tija ofroj materialit zgjedhor- librin e votimit respektivisht evidentimin e personave që kane asistuar për votuesit me asistencë në vendvotimin 0318e/02d.

Brenda fatit të përcaktuar PZAP-it pranoi përgjigjen e kërkuar nga KQZ-ja me nr. protokolli 1225A/2016 të cilës përgjigje i ka bashkangjitur materialin zgjedhor – librin e votimit, respektivisht evidentimin e personave që kane asistuar për votuesit me asistencë për vendvotimin 0318e/02d.

PZAP-i me datën 06.12.2016 nëpërmjet telefonit zyrtar mori deklaratën edhe Arlind Istogut kryesues i vendvotimit 0318e/02d i dyshuar lidhur parregullsitë e pretenduara nga pala ankuuese.

Në deklaratën e dhënë për PZAP-in nëpërmjet telefonit zyrtar, kryesuesi i vendvotimit Arlind Istogu thekson se nuk është vërtet se i ka asistuar ndokujt, por se një person në moshë duke votuar ka qenë duke e rrëzuar kabinën e votimit dhe se un jam ofruar por se koha kur unë jam afruar ai veç se ka votuar dhe un nuk kam asistuar kjo mund të

shihet edhe nga video incizimi ku unë i kam pasur duar mbrapa, krejt këto mund të vërtetohen edhe nëpërmjet dëshmitarëve tjerë.

PZAP-i me datën 06.12.2016 nëpërmjet telefonit zyrtar ftoi në cilësinë e dëshmitarit Fatlum Hasani nga BIRNI ku i njëjti për arsye personale nuk dha deklaratë nëpërmjet telefonit por se i njëjti u ftua nga PZAP-i që të nesërmen pra me datën 07.12.2016 të vijë në PZAP dhe të jap deklaratë.

Me datën 07.12.2016 Fatlum Hasani në cilësinë e dëshmitarit erdhi në zyrat e të PZAP-it, ku i njëjti dha edhe deklaratën me shkrim e cila deklaratë u protokollua me nr. protokollit 115/2016 në të cilin deklaratë i lartpërmenduri thekson se kryesuesin e kam parë të afrohet tek kutia e votimit ku votonte një plak rreth të shtatëdhjetave, ndërsa kryesuesi i ofron asistencë plakut.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj pretendimet e palëve ne procedure dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se ankesa është e **pabazuar** për këto arsye:

PZAP-i vlerëson se pretendimi i parashtruesit të ankesës se kryesuesi i vendvotimit 0318e/02d Arlind Istogu ka asistuar tek votuesi, është i paqëndrueshëm dhe nuk është argumentuar nga parashtruesi i ankesës me asnjë provë dhe nuk është i bazuar në ligj sepse nga video incizimi i ofruar nga parashtruesi i ankesës nuk mund të vërtetohet se personi që shihet në videoincizim të ketë asistuar votuesin. Po ashtu edhe nga deklarata e dhënë me shkrim në PZAP nga ana e dëshmitarit të BIRNIT nuk është vërtetuar se cila ka qenë asistenca e ofruar nga ana e kryesuesit të vendvotimit për votuesin gjate momentit të votimit. Neni 94 i LZP-së përcakton qartë se kryesuesi, anëtarët e KVV-së dhe vëzhguesit e akredituar të pranishëm lejohen të bëjnë shënime apo vërejtje në librin e votimit (librin e shënimeve në vendvotim) në të cilën shënohen ngjarjet që ndodhin në vendvotim.

Për më tepër PZAP konsideron se nga materiali i hetuar zgjedhor - librin e votimit, (librin e shënimeve në vendvotim) nuk është gjetur dhe nuk është vërtetuar se është raportuar apo te jetë evidentuar ndonjë vërejtje nga ndokush lidhur me parregullsinë për të cilën pretendon pala ankuese me ankesën e tij.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë, bazuar në nenin 6 par. 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, dhe lidhur me nenin 118 par. 1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.109/2016 më datën 07.12.2016.



v.d

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, mund të paraqet ankesë brenda afatit prej njëzet e katër (24)orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi në Gjykatën Supreme.